



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Prill 2021

Nr: 249

**VENDIM**

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N**

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Në KQZ është administruar shkresa e kryetarit të njësisë të qeverisjes vendore Kurbin për dhënie autorizim për ndryshimin e vendndodhjeve të 2(dy) qendrave të votimit, nga ndërtesa publike në ndërtesa publike. Kryesisht shkak i referuar për zhvendosje është mosrealizimi në kohë i rikonstruksionit të objektit, ambjentet e të cilie do të shërbenin si vendndodhje e këtyre QV-ve.

Nga verifikimi i kryer në terren nga Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, referohet e njëjta situatë sikundër kryetarët e njësisë të qeverisjes vendore.

**PËR KËTO ARSYE**



Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, paragrafi 4, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

### **VENDOSA:**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 0920 dhe 0920/1, në ambjentet e shkollës 9-vjeçare, “Migjeni”, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.
2. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Kryetari e njësisë së qeverisjes vendore të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

